



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 15.4.2023

Nr: 361

Ora: 10:30

VENDIM

PËR

MIRATIMIN E PËRMBAJTJES SË FLETËS SË VOTIMIT PËR KANDIDATËT PËR KËSHILLIN E BASHKISË TIRANË, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Sot, më datë 15.4.2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtova çështjen,

OBJEKT: Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, Bashkia Tiranë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

BAZË LIGJORE: Neni 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe nenit 98, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimit nr. 8, datë 23.2.2023, të Komisionit Rregullator “Për procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve në fletët e votimit, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”, të ndryshuar.

VËREJ:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve brenda afateve të përcaktuara në nenin 67, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ka regjistruar për të marrë pjesë në zgjedhjet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, listat e kandidatëve të partive dhe koalicioneve të regjistruara më parë si subjekte zgjedhore.



Me vendimin nr. 8, datë 23.2.2023, Komisioni Rregullator “Për procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve në fletët e votimit, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, ka përcaktuar procedurën për hedhjen e shortit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbështetje të nenit 98, pika 3 dhe 4, duhet të miratojë përmbajtjen e fletës së votimit për subjektet zgjedhore që garojnë në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Në mbledhjen e datës 13.4.2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve organizoi shortin sipas procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 8, datë 23.2.2023, të Komisionit Rregullator dhe në përfundim të zhvillimit të shortit, u përcaktua renditja që do të kenë subjektet zgjedhore në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Renditja në fletën e votimit për kandidatët për këshillin e bashkisë do të bëhet sipas numrit rendor të dalë nga rezultati i shortit për subjektet zgjedhore të cilat kanë depozituar lista shumemërore.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, nenin 98, pika 3 dhe 4 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, vendimit nr. 8, datë 23.2.2023, të Komisionit Rregullator “Për procedurën e hedhjes së shortit për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve në fletët e votimit, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”, të ndryshuar.

VENDOS:

1. Miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për anëtarë të këshillit bashkiak, Bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, sipas lidhjes që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



FLETË VOTIMI

Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore, 14 maj 2023

QARKU Tiranë
BASHKIA Tiranë

ZAZ Nr.
QV Nr.

KANDIDATËT PËR KËSHILLIN E BASHKISË

shënimi i
votuesit

1		BASHKË FITOJMË		BF	
2		PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË	EDI RAMA	PS	
3		PARTIA AGRARE AMBJENTALISTE E SHQIPËRISË	AGRON DUKA	PAA	
4		PARTIA REPUBLIKANE SHQIPTARE	FATMIR MEDIU	PR	
5		PARTIA LEVIZJA E LEGALITETIT	SHPËTIM AXHANI	PLL	
6		PARTIA DEMOKRACIA SOCIALE	PASKAL MILO	PDS	
7		ALEANCA LIBERALE E DJATHTË		ALD	
8		PARTIA SOCIALDEMOKRATE	TOM DOSHI	PSD	
9		PARTIA DEMOKRATIKE	ENKELEJD ALIBEAJ	PD	
10		ALEANCA PROGRESISTE L.ZH.K	DASHAMIR SHEHI	LZHK	
11		FRYMA E RE DEMOKRATIKE	SALI SHEHU	FRD	
12		PARTIA DREJTËSI, INTEGRIM DHE UNITET	SHPËTIM IDRIZI	PDIU	
17		ALEANCA ARBNORE KOMBËTARE	GJET NDOJ	AAK	
18		PARTIA BALLI KOMBËTAR	ADRIATIK ALIMADHI	PBK	
24		PARTIA KONSERVATORE	BASHKIM MURATI	KONS	
35		NISMA THURJE	ENDRIT SHABANI	NTH	
36		LËVIZJA BASHKË	ARLIND QORI	BASHKË	